

University for Business and Technology in Kosovo

**UBT Knowledge Center**

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Spring 5-2021

## **FAKTORËT MOTIVUES PËR PUNONJËSIT E KOMPANISË NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C.**

Emira Krasniqi Vela

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)

---

### **Recommended Citation**

Vela, Emira Krasniqi, "FAKTORËT MOTIVUES PËR PUNONJËSIT E KOMPANISË NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C." (2021). *Theses and Dissertations*. 2703.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2703>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



Kolegji UBT  
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**FAKTORËT MOTIVUES PËR PUNONJËSIT E KOMPANISË  
NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C.  
Shkalla Bachelor**

Emira Krasniqi Vela

Maj, 2021  
Prishtinë



Kolegji UBT  
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome  
Viti akademik 2017-2018

Emira Krasniqi Vela

**FAKTORËT MOTIVUES PËR PUNONJËSIT E KOMPANISË  
NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C.**

Mentori:  
Prof. Mrs. Ilir Salihu

Maj, 2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të  
pjeshme për Shkallën Bachelor

## **ABSTRAKT**

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në biznes në ditët e sotme, sepse njerëzit dhe njohuritë e tyre janë aspektet më të rëndësishme që ndikojnë në produktivitetin e kompanisë. Një nga aspektet kryesore të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është motivimi dhe matja e kënaqësisë së punonjësve.

Kompanitë duhet të sigurohen që kënaqësia e punonjësve është e lartë në mesin e punëtorëve, gjë që është një parakusht për rritjen e produktivitetit.

Ky punim analizon efektin e motivimit të punonjësve në organizatë dhe llojet e ndryshëm të motivimeve. Gjithashtu punimi hedh dritë mbi atë që e shtyn një punonjës të punojë më mirë për përfitimet e përgjithshme të organizatës.

Punimi gjithashtu analizoi sisteme të ndryshme të shpërblimit dhe mënyrën se si mund të përdoret nga një kompani, gjithashtu shikon kulturën organizative dhe si ndikon në sjelljen e punonjësve.

Pjese e punimit është dhe analiza që është kryer në kompaninë Ferronikeli, përmes një pyetësoi ku nga 1200 punëtorë, pyetësoret janë dorëzuar tek 500 punëtorë. Punëtorët që morën pjesë ishin punëtorët me ndërrime dhe me orar administrativ, nga të gjitha departamentet, dhe që në kompani kanë punuar në periudha të ndryshme kohore.

Pyetësoi është i ndarë në katër pjesë të ndryshme, dhe të dhënat e dala nga pyetësoi janë analizuar dhe paraqitur në këtë raport në katër kritere: Komunikimi në vendin e punës, të ardhurat e punonjësve, stimujt afatgjatë dhe stimujt jo-financiarë.

Ky hulumtim është ekzekutuar në mënyrë që të matet kënaqësia e tanishme motivuese e punonjësve si dhe faktorët dhe stimuluesit në kompani.

## FALËNDERIME

*Fillimisht do të falënderoja Prof. Ilir Salihun në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjise në Prishtinë. Falenderoj edhe menaxherët dhe punëtorët e NewCo Ferronikel-it të cilët ishin cdo herë të gatshëm të bashkpusojnë duke plotësuar pyetësorët dhe duke më dhënë informata që më duheshin për ta realizuar këtë projekt.*

*Falenderoj prindërit e mi, motrën time dhe vëllaun për dashurinë dhe mbështetjen e tyre gjatë gjithë jetës sime. Prindërit më dhanë forcë për të të ndjekur ëndrrat e mia, më mësuan pavarësinë, këmbënguljen dhe vendosmërinë.*

*E fundit dhe më e rëndësishmja familjes time, burrit tim Uran Vela dhe femijët të cilët janë dashuria këmbëngulja dhe motivi më i madhë i të gjitha të arriturave të mia.*

## **PËRMBAJTJA**

<b>1</b>	<b>HYRJE.....</b>	<b>1</b>
1.1	Profili dhe historiku i shkurter i kompanisë.....	1
1.2	Rëndësia e studimit.....	3
1.3	Çfarë është motivimi?.....	4
<b>2</b>	<b>TEORITË E MOTIVIMIT .....</b>	<b>7</b>
2.1	Teoria e Maslov-it.....	7
2.1.1	Nevojat Fiziologjike .....	8
2.1.2	Nevoja e Sigurisë.....	8
2.1.3	Nevoja Sociale.....	9
2.1.4	Nevoja e respektit dhe vetërespektit - Ego .....	9
2.1.5	Vetëaktualizimi.....	9
2.2	Teoria e Herzbergut .....	10
2.3	Teoria Erg e Alderfer-it .....	11
2.4	Teoria e Adamit .....	14
2.5	Teoria e Vroom-it – Teoria e jetëgjatësis .....	15
2.6	Teoria e McGregor X dhe Y .....	16
<b>3</b>	<b>LLOJET E MOTIVIMIT .....</b>	<b>18</b>
3.1	Motivimi i brendshëm dhe i jashtëm .....	18
3.1.1	Motivimi i brendshëm .....	19
3.1.2	Motivimi i jashtëm .....	20
3.2	Stimuluesit / nxitja.....	21
3.2.1	Nevoja për stimulim - nxitës .....	21
<b>4</b>	<b>METODAT HULUMTUESE.....</b>	<b>22</b>
4.1	Analiza dhe interpretimi i të dhënave .....	22
<b>5</b>	<b>GJETJET, SYGJERIMET, DHE KONKLZIONI .....</b>	<b>33</b>
<b>6</b>	<b>REFERENCAT .....</b>	<b>35</b>

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Hierarkia e Nevojave - (Maslow 1943).....	8
Figura 2. Teoria dy faktorë .....	11
Figura 3. Nxitësit Financiar dhe Jo Financiar.....	21
Figura 4. Grafikoni - përgjigjja për mbështetjen nga burimet njerëzore .....	22
Figura 5. Grafikoni - Interesimi i menaxhmentit për motivim të punëtorëve .....	23
Figura 6. Grafikoni - Llojet e nxitësve për motivim.....	24
Figura 7. Grafikoni - Kompania është mirënjohse për punën e punëtorëve.....	25
Figura 8. Grafikoni - Rritje periodike të pagave .....	26
Figura 9. Grafikoni - Në kompani ka siguri të madhe të punës .....	27
Figura 10. Grafikoni - Marrëdhëniet e mira në mes të bashkë-punëtorëve.....	28
Figura 11. Grafikoni - Sistemi i vlerësimit efektiv i performancës.....	29
Figura 12. Grafikoni - Mundësitë promovuese në punë.....	30
Figura 13. Grafikoni - Faktorët që ju motivojnë më së shumti .....	31
Figura 14. Grafikoni - Menaxheri/ja ju bënë pjesëmarrës në vendimmarrje të cilat janë të lidhura me departamentin tuaj .....	32

## **LISTA E TABELAVE**

Tabela 1. Përgjigjja për mbështetjen nga burimet njerëzore .....	22
Tabela 2. Interesimi i menaxhmentit për motivim të punëtorëve.....	23
Tabela 3. Llojet e nxitësve për motivim .....	24
Tabela 4. Kompania është mirënjohse për punën e punëtorëve .....	24
Tabela 5. Rritje periodike të pagave .....	25
Tabela 6. Në kompani ka siguri të madhe të punës .....	26
Tabela 7. Marrëdhëniet e mira në mes të bashkë-punëtorëve .....	27
Tabela 8. Sistemi i vlerësimit efektiv i performancës .....	28
Tabela 9. Mundësitë promovuese në punë .....	29
Tabela 10. Faktorët që ju motivojnë më së shumti.....	30
Tabela 11. Menaxheri/ja ju bënë pjesëmarrës në vendimmarrje të cilat janë të lidhura me departamentin tuaj. ....	31



# **1 HYRJE**

Motivimi i punëtorëve është mjeti thelbësor për suksesin e çdo organizate.

Lënda e këtij hulumtimi është "Faktorët motivues për punëtorët e kompanisë NewCo Ferronikeli Complex L.L.C.

Studimi është bërë në NewCo Ferronikeli LLC, kompani e cila përfaqëson rastin studimor të kësaj pune kërkimore.

Për t'u angazhuar në motivimin e punëtorëve, punëdhënësit duhet të kuptojnë nevojat dhe pakënaqësitë e secilit prej punëtorëve. Ky studim ka për qëllim të sigurojë aftësinë për të njohur motivatorët për punëtorët në këtë kompani dhe marrëdhëniet e tyre me angazhimin organizativ.

## **1.1 Profili dhe historiku i shkurter i kompanisë**

NewCo Ferronikeli Complex LLC- është njëra ndër kompanitë më të mëdha eksportuese në Kosovë. Kjo kompani është privatizuar në prill të vitit 2006 nga kompania Cunico Resources.

Kompleksi përfshin fabrikën e prodhimit të nikelit, si dhe depozitat potencialisht minerale në afërsi të Gllogocit.

NewCo Ferronikeli është ndërtuar në vitin 1984 dhe kjo kompani para privatizimit në kohën e blerjes ishte në gjendje shumë të keqe si pasojë e bombardimeve gjatë konfliktit të fundit të 1990-99-s. Pas blerjes Cunico Resources ka qenë në gjendje të rinovoj furrat elektrike, furrat rrotulluese dhe makinat hedhëse, bazuar në dizajnet perëndimore. Në NewCo Ferronikelin detyrimi i blerësve ishte të investojë 20 milionë euro gjatë vitit të parë, por investimi ka arritur në më shumë se 40 milionë euro.

Ky kompleks është transformuar në kompani me pajisje moderne duke përdorur sigurinë e punës dhe standardet e mjedisit në përputhje me kërkesat e BE-së. Është njëra ndër kompanitë më të mëdha private në Kosovë. Ajo është ndër kompanitë më të mëdha tatim paguese, ndër punëdhënësit më të mëdhenj, një ndër Konsumatorët më të mëdhenj të energjisë elektrike dhe klienti më i Madh i hekurudhave të Kosovës. Gjithashtu, NewCo Ferronikeli është një ndër eksportuesit më të mëdhenj në Kosovë. Në këtë Kompleks,

momentalisht janë duke punuar 1200 punonjës dhe shumë më tepër me anë të kontraktorëve. Çdo vit është rritur sasia e prodhimit si dhe eksporti.

NewCo Ferronikeli është vlerësuar dhe certifikuar për përmbushjen e kërkesave të ISO 9001: 2008- menaxhimi i cilësisë, si dhe është vlerësuar dhe certifikuar për përmbushjen e kërkesave të ISO 14001: 2004- menaxhim të mjedisit.

Gjatë stazhit tim të punës në kompanin NewCo Ferronikeli kemi kaluar nëpër periudha të ndryshme, në periudha kur çmimi i nikelit ka levizur shume, gjithashtu gjatë kësaj periudhe kohore ka pasur edhe ndryshime në menaxhment, p.sh në departamentin e prokurimit ku kam punuar gjatë 8 viteve pune, jane ndërruar 4 menaxherë të cilët kanë qenë nga vende të ndryshme të botës, të tilla si Izraeli, Greqia, India etj. Po ashtu menaxherët janë ndërruar edhe në departamentet e tjera dhe secili ka pasur mënyrat e tyre të menaxhimit dhe mënyra të ndryshme të komunikimit me punëtorë. Të gjithë këta faktor kanë ndikuar në motivimin apo demotivimin e punëtorëve.

Në rastet kur menaxherët si metodë të punës së tyre e kanë pasur që punëtorët e tyre ta kenë një lloj autonomie dhe vetkontrolli, ku punëtorët kanë pasur autoritet për të marrë vendime, kjo ka shtuar fuqishëm nivelin e energjisë dhe të përqëndrimit në punën e tyre. Në këto periudha, sasia e prodhimit është rritur dhe shume pak ka pasur vonesa apo ndonje proplem ne realizimin e projekteve dhe punëve nga secili departament. Mirëpo kur menaxherët jua kanë bërë të ditur punëtorëve që ata thjesht duhet ti zbatojnë urdhërat dhe nuk kanë autonomi veprimi, apo nuk mund të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje. atëherë sasia e prodhimit ka rënë, poashtu dhe në departamentet e tjera është vërejtur jo efikasiteti i punës.

Gjatë periudhës kohore sa kam punuar ne NewCo Ferronikeli, kam qenë prezente në periudha të ndryshme nëpër të cilat kanë kaluar punëtorët e kësaj kompanie. Ka pasur peridhudha kohore kur punëtorët kanë protestuar për paga dhe për kushte më të mira në punë; ka pasur periudha kohore kur ka pasur aksidente të mëdha ku ne disa raste edhe kanë vdekur punëtorë nga ai aksident gjatë orarit të punës; prishje të mëdha që kanë shkaktuar shumë dëme materiale dhe të gjitha këto kanë ndodhur pasi që dihet që puna në këto natyra të biznesit (prodhimi i nikelit) ka rrezikshmëri të madhe dhe kërkohet një disiplinë dhe një organizim shumë i sofistikuar. Në këto periudha kohore, menaxherët e mençur i kanë shfrytëzuar këto kriza për të riformuluar shprehitë organizative. P.sh., pas

aksidentit të vdekjes së një punëtori, atëherë siguria në punë është bërë si diçka primare duke u rritur për 60%. Të gjithë punëtorët kanë poseduar manualin me rregullat se si duhet të jenë të pajisur pasi të hynë në fabrikë në pjesën ku bëhet prodhimi, dhe në rast të mos respektimit të këtyre rregullave atëherë punëtorët kanë marrë vërtetjje me shkrim. Nëse edhe për herë e dytë, nuk janë respektuar rregullat, punëtorët janë larguar nga puna. Pra, kjo ka bërë që të krijohet në shprehi që punëtorët cdo herë të jenë të pajisur me helmata këpucë dhe gjëra të tjera të nevojshme, kështu që siguria e punës është rritur shumë.

Po ashtu në rastet kur ka pasur zbritje të çmimit të nikelit në treg, atëherë kjo krizë është shfrytëzuar për efikasitet shumë më të madh në punë. Punëtorët kanë qenë shumë mirënjohës dhe kanë dhënë maksimumin e tyre si shenjë falenderimi për mos përjashtim nga puna ose për mos zbritje të pagës duke qenë deshmitarë që kompanija në atë periudhë kohore ka punuar në humbje kjo ka ndodhur në kohën kur ka qenë kriza ekonomike botërore në 2007-2010 dhe sigurisht që kjo krizë e ka prekur edhe Ferronikelin. Në këtë kohë çdo procedurë cdo rregullore ka qenë më e lehtë të ndryshohet sesa në gjendje kur nuk ka pasur krizë jo nga frika por për arsye të krizës.

Pra këto periudha të krizave disa menaxherëve kanë arritur të ju shërbejnë që të bëjnë gjëra të cilat kanë qenë shumë më të vështira për tu realizuar më parë, sidomos në kompanitë e mëdha në këtë rast me 1200 punëtor.

Ky studim është bërë në vitin 2019 dhe 2020 dhe rezultatet e pyetësorëve janë marrë në vitin 2020.

## **1.2 Rëndësia e studimit**

Studimi ka për qëllim që të vlerësojë motivimin e punëtorëve në organizatë. Motivimi ka shumëllojshmëri të efekteve. Këto efekte mund të shihen në kontekstin e një individi të cilat ndikojnë në mënyrë fizike, mendore, shëndetësore, produktivitetin në punë, mungesat, dhe kënaqësinë e punëtorëve që të menaxhohen dhe të motivohen me metoda të hulumtuesve të ndryshëm të cilat janë të shpjeguara shkurtimisht në kapitujt e radhës.

### 1.3 Çfarë është motivimi?

Motivimi është elementi kryesorë në vendosjen dhe arritjen e qëllimeve.

Të gjitha këto të arritura që janë bërë deri më sot në të gjitha lëmitë janë si rezultat i motivimit.

Efikasiteti i një kompanie mbështetet në efikasitetin e punëtorëve të saj,

Young (2000) thotë se motivimi mund të përkufizohet në mënyra të ndryshme, varësisht se kënd ju pyesni. Po ti pyesim disa njerëz në rrugë, ju mund të merrni një përgjigje si " është ajo që na drejton " ose " është ajo çfarë na bënë të bëjmë gjërat që ne bëjmë". Prandaj motivimi është forca brenda një individi, këmbëngulja e përpjekjeve të bëra në jetë të përditshme në punë".

Kreinter (1995), Buford, Bedeian & Linder (1995), Higgins (1994) të gjithë në Linder (1998) e kanë definuar motivimin si proces psikologjik që sjelljet e njeriut e kanë një synim dhe drejtim, me predispozita që të sillen në një mënyre specifike vetëm për të arritur atë çfarë ai ka për qëllim.

Halepota (2005) përcakton motivim si " pjesëmarrje dhe vendosmeritë e një personi aktiv për të arritur rezultatet e parashikuara. " Halepota më tej paraqet se koncepti i motivimit është abstrakt sepse strategjitë e ndryshme prodhojnë rezultate të ndryshme në kohë të ndryshme dhe nuk ka asnjë strategji të vetme që mund të prodhojë rezultate të garantuara të favorshme gjatë gjithë kohës".

Sipas Antomioni (1999), " fuqia e përpjekjeve të njerëzve që janë të gatshëm për të dhënë në punën e tyre varet nga shkalla në të cilën ata ndjehen që nevojat e tyre motivuese do të jenë të kënaqshme.

Një ndër njerëzit më të pasur dhe më të suksesshëm në botë Sir Richard Branson themeluesi dhe pronari i kompanive Virgin në librin e tij *Like a Virgin: Secrets They Eön't Teach You at Business School*. thotë se në kompanitë e tij ata i japin prioritet motivimit të punëtorëve para çdo gjëje edhe para klientave, në mënyrë që të ndihen të vlerësuar si punëtorë dhe qenie njerëzore.

Richard Branson e kupton se kur nevojat e punëtorëve të tij përmbushen në nivel njerëzor, kjo ndikon në efikasitetin e bizneseve të tij për një shkallë më të lartë.

Nëse personi që punon në kompaninë tuaj është 100% krenar për punën që bëjnë, nëse u jepni atyre mjetet për të bërë një punë të mirë, dhe janë krenarë për markën, ata do të jenë të lumtur, nëse ata ' do të jenë të lumtur do të jenë shumë të kujdesshëm ndaj konsumatorëve dhe për këtë arsye konsumatorët do të kenë një eksperiencë të mirë. Nëse personi që punon për kompaninë tuaj nuk është trajtuar si ai deshiron, nuk i ipen detyrat e duhura dhe nuk është i kënaqur, nuk do ta ketë motivin që ta jap më të mirën nga vetja për ta kryer punën si duhet ose për tu kujdesur për konsumatorin në mënyrën më të mirë dhe për këtë arsye konsumatori do të trajtohet në atë mënyrë ku shpesh ata nuk do të duan të kthehen sërish. Filozofia e Richard Brandson është dhe ka qenë gjithmonë që, nëse mund të renditni për nga rëndësija renditja duhet të bëhet kështu në kompani stafi në rend të parë, klientat në rend të dytë dhe aksionerët në rend të tretë. Kjo praktikë e biznesit gjithnjë e më shumë po bëhet normë për mënyrën se si drejtuesit ekzekutiv kryesojnë kompanitë e tyre - madje edhe në disa prej markave më të mëdha në planet thote Richard Brandson sa herë që pyetet për motivimin e punëtorëve dhe për suksesin e kompanive të tij.

Pasi në fund të gjithë do të jenë të kënaqur por më së shumti Aksionarët.

"Nëse kujdeseni për punëtorët tuaj, punëtorët tuaj do të kujdesen për klientët tuaj dhe klientët tuaj do të kujdesen për aksionerët tuaj". Kjo është kultura e Virgins që e ka ndërtuar gjatë viteve thote Richard Brandson në librin e tij *Like a Virgin: Secrets They Don't Teach You at Business School*.

Sigurisht është e ditur që për shumicën e kompanive qëllimi kryesorë i tyre është që të arrijn profit sa më shumë nga ai shërbim apo ai produkt që ajo kompani e ofron në treg. Por të arrish profit si kompani fillimisht duhet ti kesh punëtorët të cilët mesazhin e kompanisë për çfarë e dallon në treg nga të tjerët apo benefitet e produktit dhe shërbimet e kompanisë ku punojnë të arrijnë ti bartin te klientat si dhe ajo më kryesorja ta shesin atë produkt.

Prandaj është i rëndësishëm të analizohet dhe herë pas here të vlerësohet motivimi i punëtorëve.

Sigurisht që menaxherët e mirë arrijnë ti dallojnë punëtorët e mirë dhe ata që janë vetëmotivues. Por sa do që të jenë punëtorët vetëmotivues ata nuk do të jenë të kënaqur

nëse e kuptojnë që si kompani qëllimi kryesor është që si Pronar ose Aksionar të bësh sa më shumë profit për vete dhe vetem aq.

Punëtorët do të jenë të motivuar nëse punojnë në ndonjë kompani ku me produktin apo shërbimin e saj si qëllim e kanë që të ndryshon cilësinë e jetës për njerëzit dhe punëtorët e saj, kjo është një karakter frymëzues për ta.

Secila kompani fillimisht duhet ta dij vizionin e saj, misionin e saj autentik që dëshiron ta ofron.

Ajo gjithashtu mund të konkludohet nga përkufizimi që ka një forcë pune të motivuar ose krijimin e një mjedisi në të cilin mundësojnë që të mbajnë nivele të larta të motivimit dhe kjo mbetet një sfidë për menaxhimin e sotëm. Kjo sfidë mund të burojë nga fakti i thjeshtë se motivimi nuk është një tipar i fiksuar, ai mund të ndryshojë varësisht nga ndryshimet e personaliteteve, psikologjike, faktorët financiarë apo social.

Është e qartë se menaxherët duhet të motivojnë punëtorët për të marrë rezultatet e dëshirueshme për organizatë dhe kjo mund të thuhet se ekziston një konsensus në lidhje me faktet që motivimi është një fenomen individual, ai është përshkruar si i qëllimshëm, është shumëdimensional dhe se qëllimi i teorive motivuese është të parashikojnë sjelljen.

Nga përkufizimet e lartëcekura të motivimit nga hulumtues të njohur botëror dhe shembuj të personave që kanë arritur shumë sukses duke i kushtuar rëndësi motivimit të punëtorëve vërehet se motivimi në përgjithësi është pak a shumë në thelb " forca e padukshme " që nxit njerëzit për të bërë diçka.

Vetëm nga performanca e mirë e punëtorëve organizatat/kompanitë arrijnë që t'i realizojnë qëllimet e kompanisë, pra kësaj teme dita ditës është duke iu kushtuar rëndësi, dhe duke u përdorur e bërë hulumtime të vazhdueshme për metodat më të suksesshme motivuese.

## **2 TEORITË E MOTIVIMIT**

Para shumë dekadave janë zbuluar dhe praktikuar teori të ndryshme të motivimit të cilat përdoren edhe sot nga shumë kompani të suksesshme.

Në bazë të definicioneve të motivimit nga shumë hulumtues të metodave të motivimit, shihet se nuk ka një metodë konkrete që duhet ta përdorin të gjitha kompanitë (menaxherët) sepse qëllimet, dëshirat, synimet e njerëzve dallojnë prandaj edhe mënyrat e motivimit nuk mund të jenë të njëjta për të gjithë. Fillimisht menaxherët duhet të informohen për gjendjen e punëtorëve dhe pastaj t'ua krijojnë kushtet dhe ambientin që të motivohen dhe të jenë në gjendje ta japin më të mirën nga vetja e tyre.

Në këtë punim hulumtues do të shpjegohen këto teori të motivimit siç janë: teoria e Maslov-it (e nevojave), teoria e Herzberg-ut (dy faktorët), teoria e Vrum-it (jetëgjatësisë), e Adam-it (teoria e barazisë), Mac Gregory (teoria X dhe Y).

### **2.1 Teoria e Maslov-it**

Sipas Maslow (1943) nevojat e njeriut mund të organizohen në mënyrë hierarkike.

Një individ është i gatshëm të veprojë sipas nevojave të rritjes nëse dhe vetëm nëse nevojat që i mungojnë i plotëson fillimisht.

Maslow (1943) sugjeron se nevojat e njeriut mund të klasifikohen në pesë kategori dhe se këto kategori mund të organizohen në një hierarki të rëndësisë së lartë. Këto përfshijnë nevojat fiziologjike, nevojat e sigurisë, nevojat sociale, të dashurisë dhe të përkatësisë, nevojat e respektit, vetërespektit (Ego) dhe nevojat e vetaktualizimit. Sipas tij një person është i motivuar para së gjithash për të kënaqur nevojat fiziologjike.

Kur nevojat fiziologjike janë të plotësuara ose të kënaqshme ai motiv pushon së vepruari si faktorë parësor motivues. Kështu lind nevoja motivi për shkallën në vijim. Ky proces vazhdon deri në fund për në vetaktualizim.

Sipas Maslov-it arsyeja pse këto motivime janë hierarkike është sepse p.sh nëse një punonjës që është shumë i uritur ose shumë i sëmurë, vështirë se do të jetë në këto motiv për të punuar e të bëjë ndonjë punë efektive.



Figura 1. Hierarkia e Nevojave - (Maslow 1943)

### 2.1.1 Nevojat Fiziologjike

Nevojat fiziologjike janë themelore: Trupi i njeriut kërkon ushqim, gjumë, oksigjen, lirinë e lëvizjes, dhe një temperaturë mesatare.

Kur ne kemi pasur mjaft për të ngrënë, ushqimi bëhet relativisht i parëndësishëm dhe menjëherë lind nevoja tjetër që është Nevoja e Sigurisë.

### 2.1.2 Nevoja e Sigurisë

Nevojat e Sigurisë veprojnë kryesisht në një nivel psikologjik.

Sapo njeriu të arrin një rehati fizike, ne do të kërkojmë për të krijuar stabilitet dhe qëndrueshmëri në një botë kaotike.

Nevojat e sigurisë manifestohen në mënyra të tilla si një preferencë për sigurinë e vendit të punës, procedurat e ankesës për mbrojtjen e individit nga autoriteti i njëanshëm, llogaritë e kursimeve, politikat e sigurimit, strehim të arsyeshëm të aftësisë së kufizuar etj.

Një vend pune përmbush nevojën fizike duke siguruar hapësirë të përshtatshme për punëtorët me ajër të pastër dhe ndriçim të mirë. Në anën tjetër, edhe punëtorin me qëndrimin më pozitiv mund ta dëmtojë nëse punon në ambient të errët të punës.



Punëdhënësit mund të plotësojnë sigurinë e punëtorëve, duke marrë preventiva kundër dhunës, ngacmimit, dhe rrezikut fizik. Punëdhënësit mund ta arrijnë plotësimin e kësaj nevoje gjithashtu duke u kujdesur që të kenë një personel të drejtë, paga të mira etj.

### **2.1.3 Nevoja Sociale**

Pasi nevojat fiziologjike dhe të sigurisë janë përmbushur, niveli i tretë i nevojave të njeriut është ndërpersonale dhe përfshijnë ndjenjat e përkatësisë. Kjo nevojë është veçanërisht e fortë në fëmijëri

Sipas Maslovit, njerëzit duhet të kenë një ndjenjë të përkatësisë dhe pranimin në mesin e grupeve të tyre shoqërore, pavarësisht nëse këto grupe janë të mëdha apo të vogla. Për shembull, disa grupe të mëdha shoqërore mund të përfshijnë klube, bashkë-punëtorëve, grupet fetare, organizatat profesionale, ekipet sportive, dhe bandat.

### **2.1.4 Nevoja e respektit dhe vetërespektit - Ego**

Të gjithë njerëzit kanë një nevojë të ndjehen të respektuar; kjo përfshin nevojën për të pasur respekt dhe vetë-respekt. Respekti paraqet dëshirën tipike të njeriut për t'u pranuar dhe vlerësuar nga të tjerët. Njerëzit shpesh angazhohen në një profesion apo hobi për të fituar njohjen.

### **2.1.5 Vetëaktualizimi**

Pika më e lartë dhe kryesore: vetë-aktualizimi.

"Ajo që një njeri mund të jetë, duhet të jetë." Ky citim formon bazën e nevojës së përceptuar për vetë-aktualizim. Ky nivel i nevojës referohet çfarë potenciali i plotë i një personi është dhe realizimi i këtij potenciali.

Të gjithë kompanitë dhe shoqëria në përgjithësi kanë dëshirë të madhe që të jenë dhe të kenë afër vetes persona të vetaktualizuar por fatkeqësisht janë shume të rrallë individë që arrijnë në këtë nivel përndryshe nëse të gjithë do të ishim të ketillë atëherë do të mbretëronte paqja në tokë dhe zbulime te reja do te bëheshin cdo ditë.

## 2.2 Teoria e Herzbergut

(Herzberg 1964) identifikohet me dy kategori të ndryshme të nevojave: faktorët higjienik dhe motivues.

Sipas Herzberg, nëse faktorët motivues janë plotësuar, punëtorët bëhen të motivuar dhe kështu kryejnë punën duke dhënë më shumë sesa është parashikuar nga punëdhënësi. Njerëzit që janë të pakënaqur me punët e tyre janë të shqetësuar në lidhje me mjedisin e punës, ndërsa individët e kënaqur ndihen rehat me punët e tyre. Kategoria e parë (faktorët higjienik) i referohet politikave organizative, mbikëqyrjes, kushteve të punës, sigurinë e parave ose të marrëdhënieve ndërpersonale. Edhe pse këta faktorë nuk janë një pjesë e brendshme e punës dhe ato nuk ndikojnë në kapacitetin e punëve shtesë tek punëtorët, faktorët higjienik parandalojnë performancën e ulët për shkak të kufizimeve të punës. Në anën tjetër, kategoria e dytë është e përfaqësuar nga faktorët që përfshijnë ndjenjën e arritjes, rritjen profesionale dhe njohjen. Këta faktorë jo vetëm që kanë një efekt pozitiv dhe japin kënaqësinë e punës, por ata gjithashtu rrisin kapacitetin total të prodhimit ose shitjes etj.

Nëse punëdhënësi i di nevojat e punëtorëve atëherë është e mundur për të vendosur qëllimet që do të krijojë mjedisi për të motivuar punëtorët. Këto parashikime janë të mundshme siç është demonstruar se paratë dhe përfitimet i plotësojnë nevojat në nivel fiziologjik dhe të sigurisë, marrëdhëniet ndërpersonale dhe mbikëqyrja janë faktorë higjienik që kënaqin nevojat sociale, ndërsa faktori motivues i motivon punëtorët që të japin më të mirën nga vetja e tyre të rrit përgjegjësinë, duke sfiduar arrijnë në nivelet e vetë-aktualizimit. Përveç kësaj, njerëzit me motivim të lartë arrijnë të priren të jenë të interesuar në motivim. Njerëzit të cilët janë të motivuar duan të dinë se sa mirë janë duke i kryer detyrat e tyre. Në të kundërtën, njerëzit me motivim të ulët janë të shqetësuar në lidhje me mjedisin e punës dhe duan të dinë se si të tjerët i perceptojnë ata dhe jo të fokusohen në efikasitetin e tyre të punës.



Figura 2. Teoria dy faktorë (Herzberg, 1964)

Prandaj, punëtorët mund të fitojnë më shumë kënaqësi në punë nëse menaxherët zgjerojnë punën e tyre. Me fjalë të tjera, numri apo llojllojshmëria e detyrave duhet të rritet për të punësuarit, pasi kjo do të rrisë nivelin e tyre të performancës. Për të arritur këto rezultate, detyrat duhen ridizejnuar dhe punëtorëve duhet t'u jepet më shumë përgjegjësi (zgjerim horizontal dhe vertikal të punëve).

Nëse njerëzit janë të përfshirë në planifikimin, organizimin, motivimin dhe kontrollin e detyrave të tyre, ata do të jenë të kënaqur, të nderuar dhe do të aktualizojnë nevojat e tyre, dhe kështu përmirësohet performanca e tyre.

Menaxherët duhet të jenë të vetëdijshëm për dallimet në mes motivimit dhe kënaqësisë. Nga njëra anë, motivimi është ndikuar nga perceptimet përpara në lidhje me marrëdhëniet në mes të performancës dhe shpërblimet në kërkim, ndërsa në anën tjetër, kënaqësia është rezultat i ngjarjeve të kaluara ka të bëjë me ndjenjat e njerëzve në lidhje me shpërblimet që ata kanë marrë. Prandaj, ky dallim është i rëndësishëm ku duke u përpjekur për të përmirësuar performancën organizative, ata duhet të përqëndrohen në të gjitha mjetet e mundshme për të rritur motivimin.

### 2.3 Teoria Erg e Alderfer-it

Clayton Paul Alderfer (i lindur më 1 shtator 1940 në Sellersville, Pensilvani) është një psikolog amerikan i cili njihet për teorinë e motivimit ERG nga 1969 i cili në këtë teori

pesë nevojat njerëzore të Maslov-it ai i ndane vetem në tri kategori: Ekzistenca, Ngjashmëria dhe Rritja.

**Nevojat e ekzistencës** përfshin të gjitha dëshirat materiale dhe fiziologjike (p.sh., ushqimin, ujin, ajërin, veshjen, sigurinë, dashurinë fizike dhe dashurinë në përgjithësi). Këtu përfshihen dy nivelet e para të Maslov-it

**Nevoja e Ngjashmërisë** përfshin ndërtimin e raporteve sociale me të tjerët, marrëdhëniet me të tjerë siç është familja, miqtë, bashkëpunëtorët dhe punëdhënësit. Kjo për arsye se ne kemi nevojë që të ndihemi të sigurt si pjesë e një grupi apo familjeje. Këtu përfshihet niveli tretë dhe i katërt i Maslov-it.

**Nevojat e rritjes**-Ndershmëria e brendshme dhe vetëvlerësimi; këto nxisin një person për të bërë efekte krijuese ose produktive mbi veten dhe mjedisin (p.sh., për të përparuar drejt vetes ideale). Këtu përfshihet niveli i katërt dhe i pestë i Maslov-it. Kjo përfshin dëshirat për të qenë krijues dhe produktiv dhe për të përfunduar detyra kuptimplotë.

Edhe pse prioriteti i këtyre nevojave ndryshon nga personi në person, teoria e ERG-së e Alberger-it jep përparësi aspektit të konkretizimit të kategorive. Nevojat e ekzistencës janë më konkrete dhe më të lehtë për tu verifikuar. Nevojat për ngjashmëri janë më pak konkrete se nevojat për ekzistencë, të cilat varen nga një marrëdhënie midis dy ose më shumë njerëzve. Së fundi, nevojat e rritjes janë më pak konkrete në atë që objektivat e tyre të veçanta varen nga veçantia e secilit person.

Marrëdhëniet midis koncepteve të teorisë ERG të Alderferit

Ekzistojnë tri marrëdhënie midis kategorive të ndryshme në teorinë ERG të Alderferit:

- Kënaqshmëria-progresion

Kalimi deri në nevojat e nivelit të lartë bazuar në nevojat e kënaqshme.

- Kalimi

Ajo që e veçon teorinë e ERG nga teoria e Maslov-it është se kalimin nga një shkallë e motivimit në tjetrën mund të bëhet jo domosdoshmërisht në mënyrë hierarkike siç e ka Maslovi që e ka si rezultat i përmbushjes së nevojave të rendit më të ulët pra duhet të

plotësohet një motivim për të arritur te tjetra shkallë, ndërsa te ERG Alderfer kjo nuk është e domosdoshme Alderfer (1969). Përparimi në rritje nga kënaqësia e lidhur me dëshirat e rritjes nuk pret që të plotësohen nevojat e ekzistencës së një personi.

- Frustrimi-regres

